



AKT THEMELIMI

Shoqeria "INTELISOFT" sh.p.k

Sot më datë 23.04.2019 unë i nënshkruari:

Z. Gezim Hoxha, shtetas shqiptar, i biri i Brahimit, dtl. 06.03.1978, lindur ne Shkoder, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoffimit nr. 024723653.

shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë "INTELISOFT" sh.p.k si më poshtë vijon:

1. FORMA LIGJORE

"INTELISOFT" sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

2. ORTAK I VETËM THEMELUES


Ortak themelues i shoqërisë është z. **Gezim Hoxha**.

3. OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë "INTELISOFT" sh.p.k është:

- ▶ Disenjim software-i. analize e sistemeve software, projektim i arkitektures dhe projektim i detajuar i sistemeve software.
- ▶ Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software. Programim i sistemeve software, kodim, instalim, integrim i të gjithë komponentëve, dokumentim, identifikim dhe korigjim i gabimeve, modifikime (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtje e të gjithë komponentëve, suport te sistemeve si një tërësi komponentësh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike;
- ▶ Testim software. Testim i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software;

1

- 
- ▶ Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit. Planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN);
 - ▶ Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë. Analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse;
 - ▶ Zhvillim sistemesh migrimi. Këtu përfshihet edhe transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re;
 - ▶ Përmirësim/upgrade sistemesh informatike;
 - ▶ Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software.
 - ▶ Objekti i veprimtarisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblese se Ortakeve.

4. SELIA

Selia e shoqërisë tregtare **"INTELISOFT" sh.p.k.**, do të jetë në adresën: "Rruga Ismail Qemali, Ap. Nr. 2".

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë dhe të zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. KOHËZGJATJA

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit për një periudhë të pacaktuar.

Afati i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të shkurtohet ose zgjatet me vendim të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Statuti i shoqërisë.

6. KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare **"INTELISOFT" sh.p.k.**, është 5.000.000,00 lek (pese milion lek) dhe është i ndarë në 1(nje) kuote dhe vlera nominale e një kuote është 5,000 000 Leke (pese milion) LEK.



Ortaku i vetëm i shoqërisë është zotërues i vetëm i kuotave të shoqërisë, (ka në zotërim 100% të kapitalit të shoqërisë)

Kuotat janë nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.

Çdo kuotë përfaqëson të drejtën e një votë.

7. ORTAKET

Ortaku i Vetëm ushtron kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Ortakëve.

8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

- Shoqëria drejtohet nga 1 Administrator.
- Administrator i parë i shoqërisë "INTELISOFT" sh.p.k., është **Znj. Dhurata Lohja**.
- Administratori emërohet me vendim të Asamblese së Ortakëve për një periudhë jo më shumë se 5 (pese) vjet.
- Përfaqësimi i shoqërisë tregtare "INTELISOFT" sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

9. SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Themeluesi

Dhurata Lohja
Dhurata Lohja



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE BELINDA ÇELAJ

NR. 1113 Rep

Taksa e pulles u likujdua



VERTETIM

Sot me date 23.04.2019 (dymije e *nentembedhjetë*), perpara meje Noteres Publike **BELINDA ÇELAJ**, Notere e Dhomes se Notereve Tirane, me adrese: Njesia Bashkiake nr.5, Rr. "Ismail Qemali" u paraqit personalisht:

Z. Gezim Hoxha i biri i Brahimit, lindur me 06.03.1978 ne Koplik, Shkoder dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per identitetin e se cilit u sigurova nga dokumenti i tij personal Leternjoftim ID me nr personal **H80306088N**.

I cili nenshkroi para meje me vullnet te lire dhe te plote Statutin dhe Aktin e Themelimit te shoqerise "INTELISOFT" sh.p.k , date **23.04.2019** dhe Une Noterja e vertetoj ate sipas ligjit

NOTERE

